



**CHILD PROTECTION HUB
FOR SOUTH EAST EUROPE**
WWW.CHILDHUB.ORG

PUNA E MULTI AGJENCIVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE



ChildHub dhe Terre des homes falenderojnë të gjithë ata që kontribuan për analizën e informacionit kryesor të siguruar mbi punën që kryejnë agjencitë e shumta për mbrojtjen e fëmijëve, në vendet e tyre. Në veçanti, falenderojmë personat e shënuar tek Aneksi, të cilët ndihmuan me mbledhjen e informacionit dhe verifikuan saktësinë e informacionit të dhënë.

Enkelejda (Kela) Bregu mori përsipër detyrën e vështirë të sintetizimit të informacionit nga burime të ndryshme. Kjo përfshinte si analizën e informacionit nga zyra si dhe komunikimin me shtetet për të plotësuar mangësitë në informacion..

Analiza është përgatitur nga Enkelejda Bregu dhe Stefani Delani, për ChildHub dhe Terre des hommes Hungari.



Terre des hommes

**PUNA E AGJENCIVE TË SHUMTA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE
ANALIZË PËR EVROPËN JUGLINDORE**



Mars 2016

T A BELA E PËRMBAJTJES

FALENDERIME	2
PARATHËNIE	2
HYRJJE	6
Shtetet që kanë kontribuar tek analiza	6
Burimet e informacionit	7
ELEMENTË TË PËRGJITHSHËM	7
Tema 1: Çështja e terminologjisë	8
Tema 2: Çështja e kufizimeve dhe funksionit	9
Tema 3: Modelet e ndryshme	10
Tema 4: Faktorë që ndikojnë dhe konteksti i gjerë	12
SITUATA NË RAJON	13
Kuadri i analizës	13
Ligjet dhe rregulloret	14
Mandati & Shtrirja	20
Struktura, përbërja dhe udhëheqja	28
Ngritja e kapaciteteve	31
Monitorimi	34
Kuptimi i efektivitetit	35
PËRMBLEDHJE & REKOMANDIME	
PËR NDJEKJE	40
BIBLIOGRAFIA E PËRZGJEDHUR	44
ANEKSI : BURIMET E INFORMACIONIT	45
Kontribuesit kryesor individual të kësaj analize	55

HYRJE

Bashkëpunimi midis agjencive dhe ai ndër-disiplinor, që punojnë si në kontakt me sektorët dhe ekipet ashtu edhe brenda tyre, është i rëndësishëm për të garantuar se fëmijët marrin mbrojtjen e duhur. Hulumtimet tregojnë se fëmijët mbrohen në mënyrë më efektive kur punojnë së bashku agjencitë dhe partnerët (Të punojmë së bashku, 2013). Kjo ndodh sepse është thujse e pamundur për një agjenci të vetme që t'i përgjigjet si duhet akuzave dhe natyrës së ndërlikuar të abuzimit të fëmijëve. Bashkëpunimi midis agjencive të ndryshme është i rëndësishëm për të garantuar se po merret gjerësisht në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës dhe se qasja e ndjekur synon të arrijë rezultate të mira për mbrojtjen e fëmijës dhe për promovimin e mirëqenies së tyre.

Theksi i vendosur tek zhvillimi i sistemeve kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, siç advokon edhe UNICEF dhe të tjerë dhe e përkrahur nga donatorë të ndryshëm, shihet si një element i nevojshëm për mbrojtje gjithëpërfshirëse për fëmijën. Kjo, bashkë me vlerësimin e përfitimeve që ka puna midis agjencive të ndryshme tek fëmijët, e cila konsiderohet shpesh si një dimension i rëndësishëm për qasjen e sistemeve ndaj mbrojtjes së fëmijëve, ka nxjerrë në pah nevojën për qëndrim më të formalizuar dhe më proaktiv ndaj bashkëpunimit midis aktorëve.

Meqë shtetet e Evropës Juglindore (SEJ) i janë përkushtuar aktivisht zhvillimit dhe ristrukturimit të sistemeve të tyre për mbrojtjen e fëmijëve dhe kanë bërë përpjekje të konsiderueshme për prezantimin dhe ngritjen e kapaciteteve të punonjësve për t'iu përgjigjur abuzimit të fëmijëve nga këndvështrimi i punës së shumë agjencive, ChildHub që është në vetvete një platformë e përbërë nga agjenci të ndryshme që drejtohet nga Zyra Rajonale e Terre des Hommes në Hungari, nisi një analizë të punës midis agjencive të shumta në rajon. Ky është raporti i kësaj analize.

Shtete që kontribuan tek analiza

Shtetet më poshtë në rajon kontribuan për analizën (Sipas rendit alfabetik):

Bosnje – Herzegovina	Maqedonia
Bullgaria	Mali i Zi
Kroacia	Moldavia
Hungaria	Serbia
Kosova	Shqipëria

Informacioni mbi të cilin u bazua kjo analizë u përftua nga dy burime – nga një analizë e literaturës së përzgjedhur dhe nga informacioni i marrë nga profesionistët dhe akademikët nëpërmjet analizës së dokumentave nga zyra; pikët e kontaktit partnerë të ChildHub në çdo shtet dhe forumi online (WIKI) i ngritur nga ChildHub (www.childhub.org).

Krahas kësaj, në analizë u përdorën edhe gjetjet nga konferenca mbi Bashkëpunimin midis Shumë Agjencive në Kosovë, në nëntor 2015, ku u bashkuan 13 shtete për të ndarë përvojat e tyre.

Duhet vënë re se informacioni mbi punën midis agjencive të shumta është shpesh i copëzuar dhe nuk bëhen rregullisht analiza dhe vlerësime. Atje ku janë kryer, shpesh janë thjesht lokale dhe jo të shtrira në vend. Për këtë arsye, një pjesë e informacionit mbi të cilin është mbështetur analiza nuk është domosdoshmërisht i saktë.

ELEMENTË TË PËRGJITHSHËM

Megjithëse puna midis agjencive të shumta duket një mënyra pragmatike dhe e drejtëpërdrejtë për mbrojtjen e fëmijëve dhe për përdorimin e burimeve dhe ekspertizës, bëhet gjithnjë e më shumë e qartë se një nga vështirësitë e para për të përkufizuar se çfarë nënkupton puna midis agjencive të shumta si në nivel të përgjithshëm edhe brenda një shteti specifik.

Kjo krijon edhe vështirësi për të bërë analiza apo krahasime, për shkak varion shumë ajo që kuptohet me punë midis agjencive dhe mënyra sesi përkthehet në masa. Pjesërisht kjo ndodh për shkak të formës konceptuale që ka puna midis agjencive brenda një vendi, por është edhe produkt i mënyrës sesi është zhvilluar puna midis agjencive brenda konteksteve, e formuar prej këndvështrimeve historike dhe kulturore.

Tema 1: Çështja e terminologjisë

Përdoren terma të ndryshëm si në literature dhe në praktikën ligjore / politikat për të shprehur angazhimin multidimensional të profesionistëve të shumtë që punojnë me problemet e abuzimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre. Terma të përbashkët përfshijnë “ekipe multidisiplinare (EMD)” dhe “ekipe multi ose ndër-institucional (EMN)”, “ekipe multi-sektoriale (EMS)”, dhe “ekipe për mbrojtjen e fëmijëve (EMF)”. Ndonjëherë këto terma shkëmbehen me njeri tjetrin. Lloyd et al (2001), i përshkruan këtë si “moçalin e terminologjisë” (fq.3).

Në praktikën e menaxhimit të rasteve të çështjeve individuale, puna e multi-agjencive përshkruhet si procesi ku *“grupe të ndryshme profesionistësh, me njohuri dhe aftësi të ndryshme si dhe agjenci të ndryshme bashkohen në një strukturë të vetme për të ofruar shërbime”*. (Payne, 2000).

Në terma të përgjithshëm, puna e multi-agjencive inkorporon konceptin e partneritetit, bashkëpunimit dhe bashkërendimit dhe përbëhet nga një rrjet profesionistësh që vijnë nga agjenci të ndryshme që punojnë bashkë për të plotësuar nevojat e grupit të klientëve (Balloch & Taylor, 2000). Bëhet fjalë për më shumë se një agjenci që punon bashkë në formë të planifikuar, bashkë dhe formale dhe adopton sisteme të reja për ofrimin e shërbimeve, i cili ekzaminon aspektet personale, sociale, edukative dhe mjedisore të jetës (McInnes, 2007).

Dallime të rëndësishme mund të bëhen midis:

Puna e multi-agjencive / multi-disiplinare – rastet kur punon më shumë se një agjenci me fëmijën, familjen ose projektin, por jo domosdoshmërisht bashkë. Shpesh termi multi-agjenci dhe ndër-agjenci përdoren në vend të njëra tjetrës.

Puna e ndër-agjencive – Kur punojnë bashkë më shumë se një agjenci, në mënyrë zyrtare dhe të planifikuar. Kjo mund të bëhet në nivele të ndryshme, qoftë strategjike ose operacionale dhe normalisht kuadrohet brenda politikës dhe praktikës (qoftë e parashikuar me ligj apo e përcaktuar tek Standardet Operacionale të Punës dhe tek Protokollet).

Puna e përbashkët – Kur profesionistët që vijnë nga më shumë se një agjenci punojnë bashkë për një projekt ose një skemë. Për shembull, terapistët e gjuhës dhe të folurit si dhe punonjësit për zhvillimin në fëmijërinë e hershme punojnë së bashku në grup për fëmijët vulnerabël.

Puna në partneritet – Një term i përgjithshëm i cili i referohet marrëdhënieve midis grupeve të ndryshme në nivele të ndryshme: organizatat dhe përdoruesit e shërbimeve, organizata të ndryshme dhe profesionistë të ndryshëm (Lloyd, 2001).

Gjatë kësaj analize, për të shmangur ngatërresat, termi “multi-agjenci” përdoret për të përshkruar procesin e përgjithshëm ku punojnë bashkë aktorë dhe partnerë të ndryshëm për të mbrojtur fëmijët dhe për t’iu përgjigjur shqetësimeve”. Është zgjedhur termi multi-agjenci në vend të termit ndër-institucionale, pasi multi-agjencia dhe multi-disiplinare përdoret shpesh në formë të përgjithshme në rajon. Për sqarim, kur i bëhet referencë specifike një modeli të caktuar pune në një shtet, atëherë citohet edhe termi që përdoret në këtë shtet.

Tema 2: Çështja e kufizimeve dhe funksionit

Shpesh diskutimet për punën e multi-agjencive nënkuptojnë se ka më shumë se një formë për të punuar bashkë për të mbrojtur fëmijët. Në fakt, nuk ka vetëm një model për të punuar multi-agjencitë, pasi modelet reflektojnë nivele të ndryshme të integritit të elementëve të bashkëpunimit dhe në veçanti kufizimi dhe funksionin e pritshëm të qasjes së multi-agjencive.

Niveli i dëshiruar i integritit varet nga fokusi dhe qëllimet e punës për objektivin dhe kohëzgjatjen e rastit. Shumëllojshmëria e mënyrave për punën e multi-agjencive ka aspekte të ndryshme që mund të përdoren për t’i dalluar nga njëra tjetra dhe që lidhen me:

- Qëllimi si vlerësimi, planifikimi i ndërhyrjes, hetimi, vendim-marrja, këshilla dhe rekomandime për drejtësinë, analiza e rastit të vdekjes së një fëmije, etj. Kjo lidhet me faktin a shikohet si një mekanizëm që mund të përdoret për menaxhimin dhe ndërhyrjen e rasteve individuale puna e multi-agjencive (normalisht duke përdorur një nga mënyrat për menaxhimin e rastit) apo shikohet si një pjesë përbërëse e veprimtarisë më të gjerë që synon të parandalojë abuzimin;

- Kriteret kryesore kur nxitet puna e multi-agjencive, e përkufizuar nëpërmjet kriterëve minimale për të adresuar nevojat e rasti (për shembull, nëse fëmija duhet të kalojë procedurat gjyqësore ose nëse është i përfshirë në një vepër penale, apo nëse ka dyshime për dëmtime serioze apo kur fëmija është ‘në rrezik’);
- Vendodhja kur kryhet puna e multi-agjencive (shërbimet sociale, prokuroria, spitali, qendra, etj);
- Udhëheqja dhe konteksti (funksioni administrativ i agjencive të ndryshme). Kjo lidhet edhe me kontekstin historik dhe kulturor ndër vite dhe sesi janë ndërmarrë ndryshime dhe zhvillime lidhur me zhvillimin e një sisteme më të gjera për mirëqenien e fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve;
- Burimet ose të disponueshme ose të planifikuara.

Tema 3: Modelet e ndryshme

Pavarësisht kufizimeve dhe funksionit, pikat e forta të punës së multi-agjencive duken tek shumëllojshmëria e opinioneve dhe ideve që paraqiten, në vend që të përpiqen t’i orientojnë mendimet e pjesëmarrësve tek një këndvështrim i përbashkët.

Megjithëse puna e multi-agjencive ka ecur me kohën, nuk ekzistojnë përshkrime për modele të mira dhe këqija; praktika të ndryshme të ngritura sugjerojnë se një model efektiv për punën në multi-agjenci duhet të marrë në konsideratë një sërë faktorësh si kontekstin e vendit; burimet në dispozicion; disponueshmërinë e shërbimeve të tjera; kapacitetet e burimeve njerëzore; dhe zhvillimin e besimit dhe marrëdhëniet e punës. Fëmijët dhe familjet të cilëve po ju shërbehet, duhet të jenë fokusi kryesor, por i duhet kushtuar vëmendje edhe personelit që do të punojë me këtë model dhe që do ta bëjë funksional.

Mund të bëhen dallime midis pesë qasjeve kryesore për punën e multi-agjencive, të cilat ose individualisht ose në kombinim, në varësi të shtetit dhe zgjedhjes që bëhet (qoftë me dëshirë ose në organikë) formojnë themelin e ‘modelit’ të zgjedhur:

1. Vendim-marrja – Të sigurohet një forum ku mund të takohen profesionistët nga agjencitë e ndryshme për të diskutuar problemet dhe për të marrë vendime.
2. Konsultime dhe trajnime – Qëllimi kryesor është ndarja e përvojës dhe ekspertizës nëpërmjet profesionistëve e një agjencie të cilët zgjerojnë njohuritë e profesionistëve të një agjencie tjetër duke ofruar konsultim dhe/ose trajnim.
3. Masa të integruara – Duke grumbulluar një gamë ekspertizash në një vend të vetëm për të ofruar një shërbim më të koordinuar dhe më gjithëpërfshirës – e thënë ndryshe “një dyqan një ndalesë”.
4. Masa të koordinuara – Synimi kryesor ishte të bashkoheshin një numër agjencish në fushën e ofrimit të shërbimeve që të adoptohet një përgjigje më e koordinuar dhe më kompakte. Kjo mund të arrihet normalisht duke caktuar një koordinator, i cili do të ketë përgjegjësinë të bashkojë shërbimet që kanë qenë të shpërndara.
5. Shërbime të ekipit operacional – Synimi për profesionistët nga agjencitë e ndryshme të punojnë bashkë çdo ditë është që të formojë një ekip kompakt të multi-agjencive që i ofron drejtëpërdrejtë shërbime klientëve.

Megjithëse modelet individuale mund të dallojnë nga njëri tjetri, kanë ngjashmëri qasjet e punës së multi-agjencive për adresimin e rasteve të fëmijëve që vuajnë nga abuzimi. Qasje të tilla janë zhvilluar me kalimin e kohës për të trajtuar një sërë problemesh për t’iu përgjigjur abuzimit të fëmijëve dhe përfshin edhe përgjegjësinë e përbashkët për të mbrojtur dhe për t’u kujdesur për fëmijët, duke adresuar në mënyrë efektive natyrën e ndërlikuar dhe të vështirë të abuzimit të fëmijës, dhe për të eliminuar “traumën që vjen nga efektet e sistemit” tek fëmijët, e cila mund të jetë si rezultat i intervistave të tepërta, ekzaminime të papërshtatshme mjekësore, ndarjen nga sistemet përkrahëse, procedurat e sikletshme gjyqësore dhe taktikat, dhe problemet në komunikim (Ells, 2000).

Tema 4: Faktorët influencues dhe konteksti i gjerë

Si u përmend edhe tek hyrja, fokusi i zhvillimit të sistemeve gjithëpërfshirëse kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve ka sjellë mënyra *ad hoc* të punës së bashkur – mbështetur gjerësisht tek preferencat dhe besimet e punonjësve individual, drejt një qasje më sistematike për bashkëpunimin.

Ka një sërë faktorësh që ndikojnë tek zhvillimi i këtyre modeleve si: konteksti, burimet, niveli i integritit, disponueshmëria e shërbimeve, kuadri legjislativ, integrimi dhe njohja e mekanizmave të mbështetur në komunitet dhe qasja drejt decentralizimit përballë me përqendrimin e sistemeve të mirëqenies sociale.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë është tipologjia e ndryshme e sistemeve kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, pasi kjo lidhet me konceptin e abuzimit të fëmijëve dhe mënyrave më të mira për t'i mbrojtur fëmijët. Për shembull, dallimet tek mënyrat sesi sistemet e mirëqenies / mbrojtjes së fëmijëve i përgjigjen shqetësimeve të abuzimit të fëmijës dhe sa orientohen drejt mbrojtjes së fëmijëve apo shërbimit të familjes, do të kenë ndikim tek natyra e punës së multi-agjencive (Gilbert, 1997).

Në lidhje me këtë pika ku prezantohet parimi i punës së multi-agjencive dhe ky transplantohen modelet mbështetur tek përvojat e marra diku tjetër ose nëse është bërë përpjekje për të forcuar atë çka ekziston tanimë në vend dhe për të krijuar një model që është kastile dhe reflekton kontekstin specifik. Për shembull, megjithëse modelet e përpunuara të punës së bashku mund të funksionojnë tek një sistem kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve, të mirë-zhvilluar, diçka më e matur që mund të vendoset në praktikë, mund të jetë një qasje më pragmatiste për t'u përdorur tek ato shtete ku si zhvillimi i sistemeve dhe ai i shërbimeve është më embrional.

Një numër i madh faktorësh që përcaktojnë funksionimin e punës së multi-agjencive përfshijnë:

- Dallimet e agjencive
- Strukturat e autoriteteve lokale dhe kufitjë
- Organizimi i stafit dhe investimi në kohë
- Pritshmëritë e individit dhe agjencive dhe përparësitë
- Synimet dhe objektivat e agjencisë
- Buxheti dhe financat
- Konfidencialiteti dhe protokoli për ndarjen e informacionit
- Zhvillimi i një gjuhe të përbashkët dhe botëkuptim i përbashkët
- Sigurimi i trajnimeve të përbashkëta.

S I T U A T A N Ë R A J O N

Kuadri për rishikimin

Për të lehtësuar analizën krahasuese të zhvillimit të operacionalizimit të punës së multi-agjencive në rajon, u morën në konsideratë një sërë dimensionesh për të krahasuar qasjet e ndryshme që ekzistojnë: ¹

Ligjet & Rregulloret – konteksti ekzistues edhe i cili legjitimon punën e multi-agjencive. Kjo përfshin edhe praktikën që janë në funksion edhe i aderohen gjerësisht, edhe pse mund të mos jenë të formalizuara në ligj.

Mandati & Shtrirja – Roli i funksionit të punës së multi-agjencive. Kjo përfshin situata kur dhe ku zbatohet puna e multi-agjencive dhe qëllimi i veprimeve.

Përbërja & Udhëheqja – Mënyra sesi punojnë së bashku agjencitë, kush merr pjesë dhe kush është përgjegjës për koordinimin/udhëheqjen.

Ngritja e kapaciteteve – Si bëhet ngritja e kapaciteteve, nga cili bëhet dhe cilët nga aëntarët e ekipeve të multi-agjencisë përfshihen.

Monitorimi – Çfarë dhe si bëhet monitorimi i punës së multi-agjencisë.

Kuptimi i efektivitetit – Deri në ç’nivel konsiderohen efektiv modelet e ndryshme të punës së multi-agjencive për mbrojtjen e fëmijëve.

Këto dimensione të ndryshme konsiderohen të ndara nga njëra tjetra për të lehtësuar krahasimet dhe për t’i dalluar këto qasje midis shteteve, por duhet kujtuar se këto dimensione janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura.

Në shumë shtete, burimet e informacionit janë të kufizuara ose nuk gjenden shumë dhe janë përfshirë edhe mendimet subjektive të profesionistëve. Ky raport përmban një përmbledhje të informacionit më të spikatur nga burimet e vendosura tek Aneksi 1. Më shumë informacion gjendet tek ëëë.chldhub.org

¹ Shënim, këto dimensione u përdorën për të ndarë përvojat dhe dijen tek Konferenca Rajonale (Kosovë, nëntor 2015).

Ligjet dhe Rregulloret

Qasja e gërshetuar e multi-agjencive në kuadrin ligjor dhe rregullator është e rëndësishme, dhe duhet të institucionalizuar dhe të adoptohen në mënyrë konsistente. Kjo përfshin edhe garantimin se burimet e nevojshme janë dedikuar për të mbështetur operacionalizimin.

Në Maqedoni, është bërë shumë punë vitet e fundit për të përkthyer reformën ligjore, por nuk ka një ligj të konsoliduar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, janë adoptuar një numër ligjesh dhe aktesh nënligjore që synojnë mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi, abuzimi dhe forma të tjera të dhunës dhe janë rregulluar çështje të të drejtave tek legjislacioni tematik dhe sektorial, por tek asnjë nuk përmendet specifikisht puna e multi-agjencive edhe pse përmendet tek **Protokolli Kuadër**. Së fundmi, për t'iu përgjigjur krizës migratore dhe të refugjatëve, Maqedonia përgatiti protokolle të përbashkëta për të punuar me të miturit e pashoqëruar dhe fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe parashikohet që këto mund të formojnë bazën për punën e multi-agjencive. Kjo situatë është edhe në **Serbi**.

Po ashtu në Serbi, nuk ka një ligj specifik për Mbrojtjen e Fëmijëve. Propozimi i Avokatit të Popullit për një Ligj për të Drejtat e Fëmijëve është që në 2012 në parlament, por nuk është miratuar ende. Ky ligj, përmend shkurtimisht bashkëpunimin midis agjencive, identifikon rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve kryesore për mbrojtjen e fëmijëve.² Megjithëse rolet specifike dhe aktorët kryesorë kanë tejet rëndësi për bashkëpunimin reciprok, nuk është parashikuar një kuadër më i detajuar për të punuar bashkë.

Shembuj nga rajoni

Protokolli Kuadër për Marrjen e Masave për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Neglizhimi që është duke u shqyrtuar aktualisht nga qeveria e Maqedonisë ka vendosur si objektiv;

“Establishing efficient operational procedures that in cases of abuse and neglect shall provide efficient, rapid and coordinated action by all agents in the process to ensure prevention of abuse and neglect and provide appropriate conditions for adequate assistance to the child. “

² Prednact Zakona o pravima deteta, Avokati i Popullit në Serbi, 2012

Megjithatë, Serbia ka adoptuar **Protokollin e Përgjithshëm për Parandalimin e Abuzimit dhe Neglizhimit tek Fëmijët**, si një mekanizëm të plotë multi-agjencive për mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës tek fëmijët, në përputhje me Nenin 19 të Konventës së OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve. Ky dokument ka qenë baza e zhvillimit të protokolleve të posaçmeqë përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm për të garantuar mekanizma për bashkëpunim midis institucioneve të sistemeve të ndryshme.

Pavarësisht se ky hulumtim sugjeron se (Ignjatovic, 2011, fq. 177) bashkëpunimi i multi-agjencive (multispektrali siç edhe i referohen) është ende në fazën e zhvillimit të hershëm dhe se bashkëpunimi midis aktorëve varion shumë nga një pjesë e vendit tek tjetra, në varësi të kontekstit specifik të bashkisë ose të qytetit.

Në **Bosnje – Herzegovinë**, është më e pranishme puna e multi-agjencive tek strategjitë sesa tek dispozitat ligjore. Megjithatë, disa prej ligjeve të reja (si të tre ligjet për përfshirjen e të miturve tek procedimet penale), specifikon detyrën e agjencive të ndryshme në punën me të miturit në konflikt me ligjin. Vitet e fundit janë ngritur mekanizma të ndryshëm referimi (protokolle ndër-agjencish) në nivele lokale për tema të ndryshme si dhuna në familje dhe rastet e fëmijëve që lypin. Në nivel kombëtar ka një Manual për Punën e Ekipit të Monitorimit Rajonal mbi detyrat dhe rolet e anëtarëve të tij. Këto mekanizma janë të shumë të copëzuara dhe të orientuara drejt një teme, megjithëse ekzistojnë më shumë nisma në nivel lokal që paraqesin konceptin e vërtetë të punës së multi-agjencive.

Edhe situata në Malin e Zi reflekton një qasje më tematike si ndaj probleme të mbrojtjes së fëmijëve dhe punës së multi-agjencisë. Për shembull, ekzistojnë një numër dokumentesh të rëndësishëm që së bashku bëjnë kuadrin e funksionimit të ekipeve multidisiplinare, përfshirë Planin Kombëtar të Veprimit për fëmijët 2013-2017 dhe Ligjin Mbi Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje. Strategjia Aktuale për Mbrojtjen kundër Dhunës në familje përcakton qëllimet dhe aktivitetet që lidhen drejtpërdrejt me rritjen e bashkëpunimit të multi-agjencive dhe përfshin zhvillimin e modelit multidisiplinar për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje, përfshirë rritjen e bashkëpunimit për të gjithë partnerët e përfshirë. Megjithatë, ligji nuk përcakton detyrim që të ngrihen këto ekipe apo nuk parashikon si duhet të funksionojnë këto ekipe.

Në **Kosovë**, legjislacioni kombëtar, kryesisht Ligji i Familjes së Kosovës, njeh rëndësinë e familjes, përfshirë rëndësinë që ka rritja e fëmijëve në familje³ dhe përgjegjësinë e prindërve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Ka një sërë institucionesh që punojnë për të garantuar të drejtat e fëmijëve siç parashikon edhe legjislacioni kombëtar, dhe duhet të bëhet dallim midis institucioneve që përgatisin politikat dhe strategjitë kombëtare më synim promovimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe institucioneve që merren me menaxhimin e rasteve individuale. **Komiteti Ndër-Ministror për të Drejtat e Fëmijëve** është formuar qysh në 2008,⁴ dhe kryesohet nga Kryeministri i Kosovës dhe bashkon të gjitha ministrinë dhe partnerët e tjerë për të garantuar se të drejtat e fëmijëve janë boshti i rregulloreve dhe veprimtarive.

Ligji i Familjes në Kosovë 32/2004 dhe Ligji për Familjen dhe Shërbimet Sociale NR. 02/L-17, shërbejnë si kuadri kryesor ligjor për të rregulluar marrëdhëniet e familjes dhe ofrimin e mbështetjes për familjet dhe individët në nevojë. Qendra e Punës Sociale në nivel vendor është struktura kryesore, e cila identifikon dhe koordinon shërbimet për fëmijët në nevojë.

Bullgaria ka përqaftuar një qasje më gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe punën e multi-agjencive nëpërmjet **Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve** (LMF) të miratuar në 2000,⁵ i cili vendos mbrojtjen e fëmijëve në qendër të politikave publike. Rregullon të drejtat, parimet dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve në nivel qendror dhe vendor si dhe ndërveprimin e këtyre të fundit për mbrojtjen e fëmijëve. Ky ligj garanton edhe pjesëmarrjen e organizatave jo-fitimprurëse dhe individëve në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve dhe aktiviteteve. Duke adoptuar LMF-në, Bullgaria prezantoi konceptin e një sistemi ku masat për mbrojtjen e fëmijëve plotësohen dhe zbatohen nga ligje të tjera të vendit, fokusuar tek fëmijët dhe familjet si Ligji mbi Arsimin dhe Ligji mbi Luftën e Kriminalitetit tek të Miturit, si dhe rregullore të tjera përkatëse në zbatim të LMF-së, si **Urdhëresa mbi Kriteret dhe standardet për shërbimet sociale për fëmijët**.

³ Neni 2, Ligji i Familjes, Kosovë, Ligj nr. 2004/32

⁴ Vendim i Kryeministrit 07/46, 3 dhjetor 2008

⁵ Fletorja Zyrtare (SG) Nr. 48 datë 13 qershor 2000. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve (CPA) miratuar në 2000-

<http://www.legislationline.org/documents/id/6203>

Legjislacioni vendas që lidhet me mbrojtjen e fëmijëve përfshin një numër të madh rregulloresh si ligje, rregullore në zbatim të ligjeve, urdhëresa e të tjera. Për çdo ligj dhe rregullore, ka tekste që kërkojnë dhe rregullojnë bashkëpunimin e multi-agjencive; si në nivel politikash edhe në nivel zbatimi, përfshirë rastet individuale. Ka një sërë organizmash që merren me adoptimin e tyre dhe duke pasur parasysh natyrën e ndërlikuar të procesit të harmonizimit të legjislacionit bullgar me atë të Bashkimit Evropian si dhe zbatimin e legjislacionit evropian, kjo shumëllojshmëri ngre pikëpyetje për papajtueshmëri midis zbatimit të ligjit dhe ekzistencës së rregulloreve kontradiktore në praktikë.

Njësoj si në **Bullgari**, edhe **Rumania** ka bërë një numër ndryshimesh tek sistemi i mbrojtjes së fëmijëve, fillimisht kërkoi të zhvendosej kujdesi i centralizuar institucional për mbrojtjen e fëmijëve, i cili përfshinte edhe qasjet e multi-agjencive ndaj mbrojtjes.⁶ Përgjegjësia për shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve (përfshirë llojet e institucioneve, mbështetjen dhe shërbimet parandaluese) është ajo e autoriteteve rajonale me funksionin që puna e multiagjencive të udhëhiqet nga një sërë dokumentesh ligjorë si ligje, vendime të Qeverisë dhe urdhra që mund të gjenden tek faqja e internetit të Ministrisë së Punës dhe Autoriteteve Kombëtare mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Ligji 272/2004 Mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve - Kapitulli I, Neni 5 (4) - (4) përcakton se roli i shtetit është të mbrojë fëmijët dhe të garantojë se po mbrohen të gjitha të drejtat nëpërmjet aktiviteteve të posaçme që kryen institucioni shtetëror dhe autoriteti publik dhe Neni 6 (e) e) për decentralizimin e shërbimeve për ndërhyrjen për mbrojtjen e fëmijëve dhe partneritetit multi-sektorial midis institucioneve publike dhe organizmave privat. Një dispozitë tjetër e rëndësishme është vendimi i Qeverisë nr. 49 i 19 Janarit 2011 që aprovon **metodologjinë kuadër për parandalimin dhe ndërhyrjen e ekipeve multidisiplinare dhe rrjeteve** në situata dhune kundër fëmijëve dhe dhunë në familje si dhe metodologjia e ndërhyrjeve multidisiplinare.

Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë një kuadër të përbashkët metodologjik për autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve dhe dhunën në familje, për ofruesit e shërbimeve dhe profesionistët që punojnë direkt me fëmijët, familjet e tyre dhe kundravajtësit/autorët e mundshëm.

⁶ Child Pact. Guth.A. Reform Steps towards Child Protection Bulgaria- Romania, A Comparative Approach

Ky dokument bashkon aspektet kryesore të metodologjisë së punës dhe procedurave që përputhen me legjislacionin dhe me aspektet specifike të çdo institucioni pjesë të parandalimit dhe ndërhyrjes tek rastet e dhunës kundër fëmijëve.

Sipas këtij vendimi, tek secili shtet është e detyrueshme të përcaktohet një ‘ekip lokal ndër-sektorial’ (EIL) për parandalimin, luftën kundër dhunës dhe shfrytëzimit. Ekzistojnë një numër dokumentash plotësues që rregullojnë punën e ekipeve multi-disiplinare që përfshijnë standardet e cilësisë minimale për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Edhe shtete të tjera në rajon kanë adoptuar një qasje më gjithëpërfshirëse për punën e multi-agjencive si në Bullgari dhe Rumania, por në formë më të thjeshtëzuar.

Për shembull, në Kroaci, **Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve** (2014-2020) vendos disa prioritete, një prej të cilave është: *‘Promovimi i pozicionit të fëmijëve tek sistemi i kujdesit social për të siguruar zbatimin konsistent të rregulloreve ligjore, bashkëpunimin midis departamenteve të ndryshëm dhe koordinimin e aktiviteteve në sisteme të ndryshme në nivel qendror dhe vendor’.*

Krahas këtyre, në Kroaci ekzistojnë dy ligje që theksojnë procedurat e bashkëpunimit midis agjencive të ndryshme: **‘Protokolli i Procedurave në Rastet e Dhunës në Familje’** dhe **‘Protokolli i Procedurave në Rastet e Dhunës midis Fëmijëve’**. Me këto dispozita, është detyrimi i organeve kompetente të marrin masa më synim parandalimin dhe luftën e dhunës, ndër të tjera, bëjnë edhe takime të rregullta në nivel lokal dhe rajonal për të ngritur metoda efektive bashkëpunimi dhe të shkëmbejnë informacion të dobishëm. Kjo përfshin si aktorët shtetërorë dhe ata jo-shtetëror, por edhe organizatat fetare.

Në **Moldavi**, Strategjia për Mbrojtjen e Fëmijëve 2014-2020 u zhvillua për të arritur objektivin kryesor për parandalimin dhe luftën kundër dhunës, neglizhimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve, promovimi i praktikave paqësore për rritjen dhe edukimin e fëmijëve; kjo strategji nënvizon disa nga masat specifike që janë marrë nëpërmjet një sërë ligjesh. Specifikisht, neni 20, Ligji nr. **140 i 14.06.2013 mbi mbrojtjen e posaçme të fëmijëve në nevojë të ndarë nga prindërit e tyre** (Fletorja Zyrtare e Republikës së Moldavisë, 2013, nr. 167-172, art.534) lidhet

me bashkëpunimin e ‘ndër-agjencive’ dhe krijimin dhe pjesëmarrjen e ekipeve multi-disiplinare gjatë vlerësimit fillestar dhe kompleks të situatës së fëmijëve dhe për zhvillimin dhe zbatimin e planit individual të kujdesit. Me këtë lidhen edhe Udhëzimet mbi mekanizmat e bashkëpunimit të ndër-agjencive për identifikimin, vlerësimin, referimin, asistencën dhe monitorimin e fëmijëve viktime dhe viktime të mundshme të dhunës, neglizhimit, shfrytëzimit dhe trafikimit, të aprovuara me Vendim Qeverie (GD no. 270 of 08.04.2014).

Një shembull për përdorimin e termave të ndryshëm, që sjellin konfuzion është në Shqipëri ku termi ‘multi-disiplinar’ dhe ‘multi-agjenci’ gjendet në ligje të ndryshme dhe shkëmbehen me njëri tjetrin. Krahas kësaj, koncepti nuk përmendet gjithmonë në mënyrë konsistente, për shembull, nuk përdoret gjithmonë tek legjislacioni primar ose tek VKM (Vendimi i Këshillit të Ministrave) dhe gjendet nëpër Standarde, Udhëzime ose Protokolle (si Protokolli i Punës për Mbrojtjen e Fëmijëve. Vetëm një ligj flet specifikisht për qasjen që duhet ndjekur kur adresohet rasti i një fëmije në nevojë për mbrojtjen nëpërmjet punës së multi-agjencive, **Ligji Për Mbrojtjen e Të Drejtave të Fëmijëve, nr. 10347, 2010.** □

Megjithëse puna e multi-agjencive nuk është shumë e artikular në Hungari, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve

(1997 XXXI) ofron një kuadër për bashkëpunim (puna e multi-agjencive i referohet dhe kufizohet vetëm në ‘mekanizma referimi’). Ligji i detyron këto institucione dhe individë të bashkëpunojnë dhe të informojnë njëri tjetrin për të promovuar rritjen e fëmijës në familje dhe parandalimin e abuzimit. Nëse personat dhe autoritetet nuk raportojnë ose nuk bashkëpunojnë me institucione të tjera, zyra e kujdestarisë ka të drejtën të informojë autoritetet përkatëse që të marrin masa disiplinore ndaj këtij individ. Sigurisht, pa pasur orientim mbi rolet dhe përgjegjësitë, bashkëpunimi rrezikon të jetë vetëm sipërfaqësor edhe kur ka raste që merren masa disiplinore.

□ Fletorja Zyrtare. Republika e Shqipërisë. 2010. Ligji mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Republikën e Shqipërisë, nr. 10347/2010.

Qasjet si ndaj ligjeve dhe politikave që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve në përgjithësi dhe puna e multi-agjencive në veçanti, variojnë dramatikisht në rajon – nga shtete që nuk kanë ligje të unifikuara për mbrojtjen e fëmijëve dhe që e adresojnë mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet një seri fushash të ndërlidhura (si trafikimi apo dhuna në familje) tek ato shtete që kanë ligje dhe politika të unifikuara.

Kjo reflektohet tek qasja për krijimin e punës së multi-agjencisë. Në disa shtete është e përqafuar në ligj, përfshirë zhvillimin e protokolleve dhe udhëzimeve operacionale, ndërsa tek të tjera përmendet rastësisht dhe duket sikur mbivendoset ose është në formë kontradiktore.

Mandati & Shtrirja

Megjithëse ekziston dëshira për punë në multi-agjenci, dhe mund të ofrojë një mënyrë efektive për të punuar me fëmijët dhe familjet, zbatimi i kësaj qasjeje mund të ndryshojë kur bëhet fjalë për vënien në zbatim.

Një tendencë që ka dalë rishtazi, jo vetëm në Evropën Juglindore, është që menaxhimi i rastit dhe puna e multi-agjencive të shihen si sinonime. Megjithatë, janë dy gjëra të ndara. Edhe pse puna e multi-agjencisë shihet si një element i menaxhimit të rastit, nuk ka pse të përfshihet si pjesë e menaxhimit të rastit (duke qenë se menaxhimi i rastit është thjesht një proces i identifikuar për të garantuar se çështja po trajtohet në mënyrë të përshtatshme, konsistente dhe në kohë). Po ashtu, puna e multi-agjencive mund të aplikohet për mbrojtjen e fëmijëve në mungesë të qasjes për menaxhimin e rastit.

Vendimet për mandatin dhe shtrirjen janë të lidhura me prezantimin e konceptit të punës së multi-agjencisë dhe nëse ekzistenca e saj është rezultat i një adoptimit të një modeli nga një kontekst tjetër.

Në Bosnje-Hercegovinë , mandati i punës multi-disiplinare varet dhe varion nga një mekanizëm tek tjetri. Për shembull, roli i Këshillit të Fëmijëve është më shumë këshillimor ndërsa mekanizmat lokal të referimit janë më shumë organë bashkëpunuese që punojnë për çështje dhe detyra konkrete. Mekanizmat lokal të referimit mbështeten tek protokolle të qarta ndër-agjencish që përshkruajnë qartë rolin e secilit prej anëtarëve. Kjo përfshin detyrimet për afatet kohore për mbajtjen e këtyre takimeve si njëherë në muaj ose çdo tre muaj apo dhe më herët nëse ka nevojë për raste me rrezik të lartë që kanë nevojë për mbrojtje.

Ndryshe, në Shqipëri punës së multi-agjencive i referohen me terma të përgjithshëm në ligj dhe është kryesisht e fokusuar tek koordinimi. Puna e multi-agjencive është më e zgjeruar tek Protokoli për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe tek VKM “Mbi mekanizmat e koordinimit të punës për referimin e rasteve të viktimave të dhunës në familje.” Puna e multi-agjencive bëhet nëpërmjet ekipeve multi-disiplinare. Supozohet të kenë një rol proaktiv për koordinimin e masave dhe zbatimin dhe rishikimin e planeve individuale për fëmijët në rrezik.

Ligji nr. 10347/2010 përkufizon si “fëmijë në rrezik” një fëmijë të drejtat dhe mbrojtja e së cilit sic përkufizohen me ligj, i ‘mohohen ose nuk i respektohen’. Sipas këtij përkufizimi, çdo fëmijë që ka nevojë për certifikatë lindjeje dhe nuk shkon në shkollë mund të konsiderohet si ‘fëmijë në rrezik’. Megjithatë, Protokoli lejon që këto raste të menaxhohen ose të adresohen nga Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve pa pasur nevojë të mblidhet grupi multi-disiplinar. Qasja e multi-agjencive rezervohet për ato raste me rrezik të mesëm dhe të ulët. Për situata të rrezikshme dhe emergjente, nuk ka kohë të thirret gjithmonë ekipi i plotë multi-disiplinar, pra Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve mund të bëjë një takim më të mbledhur, për shembull, vetëm me punonjësin e policisë dhe me mjekun (në varësi të nevojës emergjente të fëmijës).

Shembuj nga rajoni

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Bashkia e Zagrebit, themeluan **Qendrën për Mbrojtjen e Fëmijëve të Zagrebit** në 2003, dhe pjesë e mandatit të saj ishte bashkëpunimi me institucione të tjera si shkollat, çerdhet, shtëpitë e kujdesit për fëmijët dhe organizata të tjera, për përfitim të fëmijëve dhe familjeve të tyre. Si e tillë, ofronte diagnozat dhe analizonte rastet e fëmijëve të abuzuar dhe neglizhuar duke ju ofruar trajtim dhe këshillim, si dhe bashkëpunonte me organizata të tjera si Brave Phone (linja emergjence).

Takimet multidisiplinare për raste me rrezik të ulët janë një shembull sesi i ka dhënë formë praktika zbatimit të politikës. Ky ka qenë një ndryshim që u prezantua gjatë rishikimit të Protokollit në konsultim me Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Kërkesa origjinale ishte që ekipi multidisiplinar të mblidhej për të gjitha rastet por kjo rezultoi e panevojshme meqë shpesh ndërhyrja kërkonte asistencën e vetëm një organizate dhe se përdorshin në mënyrë të panevojshme burimet e kufizuara.

Çdo bashki në Kosovë, nëpërmjet drejtorive përkatëse (zakonisht Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS) është përgjegjëse për të garantuar shërbime sociale dhe familjare brenda territorit. Roli i DSHMS-së është të identifikojë natyrën dhe deri në ç'masë nevojiten shërbimet sociale dhe familjare, nëpërmjet planeve vjetore dhe ruajtjes të së dhënave dhe statistikave, si dhe për të garantuar se Qendra për Punë Sociale (QPS) ka burimet sipas standardeve që ka caktuar Ministria. Në fakt, shërbimet konkrete i ofron Qendra për Punë Sociale (ndryshe në Shqipëri i thonë Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve) dhe nëpërmjet përkrahjes financiare dhe formave të tjera që japin OJQ-të për të siguruar këto shërbime.

Duke qenë se ofruesi kryesor i shërbimeve është QPS-ja, çdo bashki ka detyrimin të ngrejë një ose më shumë qendra, të cilat duket të kenë staf të trajnuar dhe profesionistë të shërbimeve sociale të kualifikuar. QPS-ja ka

detyrimin të kryejë vlerësimin profesional për çdo familje dhe individë në zonën e tyre që referohen ose që vërehene nga QPS-ja, të cilët kanë nevojë ose duket se kanë nevojë për shërbime sociale dhe familjare.

Kosova ka zhvilluar një model të punës së multi-agjencive (e quajtur ‘tryeza të rumbullakta’) të cilat kërkojnë pjesëmarrjen e agjencive të ndryshme dhe partnerëve, dhe menaxheri i rastit nga Qendra për Punë Sociale ka rolin e koordinimit. Drejt fundit të 2015, Kosova hartoi një protokoll për të rregulluar funksionin e Tryezave të Rumbullakta. Pak a shumë e ngjashme është edhe Protokollin në Shqipëri.

Kroacia ka organizim më fleksibël për kërkesat e punës së multi-agjencive. Për situata më rrezik të lartë, protokollin e përcakton të detyrueshëm bashkëpunimin (has pas hapi) midis institucioneve të ndryshme (p.sh. shkolla, Qendra për Mirëqenie Sociale dhe policia për raste të tjera të mbrojtjes së fëmijëve). Janë individuale rastet kur një organizatë (për shembull shkolla) punon me raste të mbrojtjes së fëmijëve (për shembull, bullizmi), por çdo profesionist që punon me fëmijët mund të vendosë të përfshijë institucione të tjerë nëse e çmojnë të nevojshme.

Ministria për Politikën Sociale dhe Rininë (MPSR) në Kroaci, koordinon dhe qeveris organet që zbatojnë politikën dhe procedurat për mbrojtjen e fëmijëve, dhe ofron asistencë financiare për projektet që janë krijuar për të përmirësuar mirëqenien dhe cilësinë e jetës së fëmijëve dhe familjeve. Më specifikisht, Ministria konsideron Qendrat për Mirëqenien e Fëmijëve si institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, që zhvillon dhe zbaton strategjinë kombëtare gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e fëmijëve si dhe përgatit, financon dhe monitoron projekte që synojnë mirëqenien e fëmijës (nëpërmjet partnerëve, OJQ-ve).

Megjithëse në Malin e Zi ka protokolle për punën e multi-agjencive, ato janë të kufizuara tek bashkëpunimi për parandalimin dhe mbrojtjen kundër dhunës në familje. Është përgatitur një protokoll kombëtar dhe është nënshkruar nga të gjitha institucionet përgjegjëse për të ngritur dhe për të zgjeruar bashkëpunimin midis agjencive si dhe për të rregulluar detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira.

Shembuj nga rajoni

Boshti i qasjes së Moldavisë për mirëqenien e fëmijës është koordinimi i punonjësve social të komunitetit me profesionistë të tjerë për të marrë vendimet, për të bërë referime dhe për të mobilizuar burimet e komunitetit për të zgjidhur problemet sociale. Punonjësi Social i Komunitetit ose menaxheri i rastit është një aktor i rëndësishëm për të koordinuar rastet në nivel lokal (MSPFC, 2009b).

Edhe në Hungari, është e kufizuar nevoja për punë të multi-agjencisë. Shërbimi për Mbrojtjen e Fëmijëve është përgjegjës për koordinimin e mekanizmave të referimit dhe për organizimin e diskutimeve të rastit kur çmohet si e nevojshme. Megjithatë, të gjithë anëtarët ishin të detyruar me ligj të raportonin raste, Shërbimi për Mbrojtjen e Fëmijëve është përgjegjës për zhvillimin e planit të kujdesit, për të informuar anëtarët për masat e marra (dhe rolin që kanë ata për zbatimin e planit) dhe për ndjekjen e rastit. Shërbimet për Mbrojtjen e Fëmijëve mund të kërkojnë një takim të multi-agjencive për çdo rast që e çmojnë të nevojshëm, por kjo nuk varet domosdoshmërisht nga lloji i rrezikut me të cilin përballet fëmija.

Në **Moldavi** mandati i punës së multi-agjencive është më i rregulluar. Ligji kërkon që ekipi multi-disiplinar të mblidhet për situata me rrezik dhe fëmijët të ndahen nga prindërit. Nëpërmjet ligjit, autoritete të ndryshme, struktura, institucione dhe specialistë me përvojë në mbrojtjen e fëmijëve, janë të detyruar të zbatojnë **Udhëzimet për mekanizmat e bashkëpunimit midis agjencive për identifikimin, vlerësimin, referimin, asistencën dhe monitorimin e fëmijëve viktime dhe viktime të mundshme dhune, neglizhimi, shfrytëzimi dhe trafikimi**. Udhëzimet përmendin edhe rëndësinë e përfshirjes së specialistëve tek të gjitha fushat e asistencës sociale, edukimit, kujdesit shëndetësor, zbatimit të ligjit tek të gjitha fazat e menaxhimit të rastit

(identifikimi dhe vlerësimi i rastit, zhvillimi dhe zbatimi i planit individual të kujdesit, monitorimit të zbatimit të masave në plan dhe kur vjen momenti edhe mbylljen e rastit).

Ndërsa në **Serbi** puna e multi-agjencive përmendet si një mënyrë efektive dhe e pëlqyer në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, për shembull, tek Plani Kombëtar i Veprimt (PKV) është vendosur qëllimi që ka ky dokument për bashkëpunimin e multi-agjencive. Problemi kryesor është mungesa e një vizioni të qartë mbi rolin dhe përgjegjësitë që çdo institucion të dijë se cilat janë përgjegjësitë në këto bashkëpunime. Prandaj, çdo institucion supozohet të specifikojë protokollë dhe rolin e tyre në proces. Këto protokolle specifike janë adoptuar dhe pse është me rëndësi të madhe të rishikohet roli i çdo institucioni dhe ndarjes së detyrave, nuk është siguruar një kuadër i detajuar mbi bashkëpunimin e thelluar.

Megjithatë, janë ngritur disa organizma në përpjekje për të rritur bashkëpunimin dhe për ta bërë më efektiv. Këto përfshijnë Këshillin Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve dhe Asambleja për të Drejtat e Fëmijëve. **Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve** është një organ koordinues dhe ka një numër funksionesh për të përmirësuar bashkëpunimin, përfshirë garantimin e mbështetjes për të hartuar Plane Lokale Veprimi dhe për bashkëpunimin me ekspertët, akademikët dhe institucione të tjera për shkeljen e të drejtave të fëmijëve.

Maqedonia është një nga shembujt nga rajoni që tregon sesi është zhvilluar nëpërmjet praktikës puna e multi-agjencive. Ka një bazë ligjore për bashkëpunimin e multi-agjencive dhe Qendrës Sociale së Procedurave dhe Standardeve për Menaxhimin e Rasteve, e cila detyron të gjithë përfaqësuesit e agjencisë të mblidhen në rastet e fëmijëve të ekspozuar ndaj dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit.

Në 2014, u ngrit një në disa bashki një model pilot i mbështetur nga UNICEF-i, për ekipet ad-hoc të multi-agjencive për t'iu përgjigjur fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë. Si rezultat i trajnimit, pjesëmarrësve ju dha rekomandim për të organizuar grupe lokale planifikimi në bashkitë e tyre për të ngritur një *ekip lokal ad hoc të multi-agjencive* për t'iu përgjigjur akuzave për dhunë dhe abuzim.

Mbështetur tek modeli i multi-agjencive i pilotuar në 2014, hapi i parë i bashkëpunimit për rastet e dyshuara të një kundravajtjeje ndaj fëmijëve ose kur fëmija është dëshmitar i një veprë të mundshme penale, përfshirë dhunën, abuzimin apo shfrytëzimin, do të raportohet njëkohësisht si tek policia dhe tek Qendra për Punë Sociale. Bashkëpunimi midis këtyre agjencive është i rëndësishëm për të garantuar këto role që plotësojnë njëri tjetrin për të parandaluar ose për të hetuar një krim (policia) dhe ndërhyr direkt për të mbrojtur dhe për t'u kujdesur ndaj fëmijëve (Qendra për Punë Sociale).

Si **Rumania dhe Bullgaria** kanë struktura komplekse dhe sisteme për punën e multi-agjencive përfshirë ato në nivel kombëtar.

Bullgaria ka organizim administrativ që trajton zbatimin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë punën e multi-agjencive në dy organe kryesore: Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve (ASMF) dhe Agjencia për Asistencë Sociale (AAS). AAS-ja është në varësi të Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale. Funkzioni kryesor dhe zbatimi i mbrojtjes së fëmijëve janë mandati i departamenteve për mbrojtjen e fëmijëve (DMF). Ato menaxhohen nga drejtoritë rajonale të Asistencës Sociale.

Misioni i Agjencisë për Asistencë Sociale është të ‘zbatojë politikën e shtetit mbi asistencën sociale’. Një pjesë e rëndësishme e politikave për mbrojtjen e fëmijëve në përgjithësi, është asistencë sociale për fëmijët vulnerabël dhe fëmijët e familjet e pafavorizuara. Duhet theksuar se politika për mbrojtjen e fëmijëve shkon përtej asistencës sociale. Megjithatë, fokusi kryesor i politikave aktuale për mbrojtjen e fëmijëve është në fakt mbështetja sociale dhe puna me fëmijët në rrezik ose të pafavorizuar. Si rezultat, kjo i le fëmijët jashtë shtrirjes së politikave të përbashkëta për mbrojtjen e fëmijëve.

Sipas Ligjit Për mbrojtjen e Fëmijëve, Drejtori për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve, menaxhon, koordinon dhe supervizon zbatimin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo përfshin licencimin dhe kontrollin e aktiviteteve të subjekteve ligjore bullgare dhe të huaja, që nënkupton ofruesit e shërbimit. Drejtori i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve nuk punon në mënyrë të pavarur, por në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikave Sociale. Përgjegjësia specifike e kësaj agjencie, mbivendoset me përgjegjësitë e komisioneve shtetërore/publike, të cilët kanë funksione kontrolli për ligjet që janë miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Pavarësisht disa ndërlikimeve tek sistemi në Bullgari, koordinimi për mirëqenien e fëmijëve dhe politikat e mbrojtjes në përgjegjësinë e një strukture të vetme në nivel kombëtar, ishte një hap tejte i rëndësishëm për të garantuar një strategji më koherente dhe zbatimin e reformave. □

□ Child Pact Coalition. Guth A. (2014) Reform Steps to Child Protection Bulgaria – Romania- a comparative approach.

Në **Rumani**, ekipet multi-disiplinare kanë rol proaktiv gjatë procesit të menaxhimit të rastit. Menaxheri i rastit bashkë me ekipin multi-disiplinar zhvillon plan individual mbrojtjeje ose sipas rastit, plane të tjera në përputhje me ligjin, brenda 30 ditësh nga identifikimi i rastit. Menaxheri i rastit bashkë me ekipin bën një rievlerësim të situatës së fëmijës çdo tre muaj ose sa herë është e nevojshme dhe e rishikon planin nëse është e përshtatshme.

Krahasi, ekipet ndër-sektorale (EIL/LCST) përbëhen nga persona të caktuar nga institucionet që përfaqësojnë administratën publike lokale dhe autoritetet administrative autonome dhe organizatat jo-qeveritare të angazhuara në monitrim, parandalim dhe luftën kundër dhunës dhe shfrytëzimit. EILs janë të ngritura në nivel konteje dhe tek çdo qark të Bukureshtit. Agjencitë, të cilat duhet të përfaqësohen, që kanë mandatin, përfshijnë një gamë të gjerë sektorësh dhe shërbimesh, përfshirë inspektoratin e punës, policinë, arsimin, shëndetin publik dhe OJQ-të.

Përgjegjësitë specifike të EIL janë të renditura tek përshkrimi i punës së çdo anëtari dhe garantojnë përgjegjshmërinë e secilit prej profesionistëve. Takimet mujore organizohen sipas procedurave të brendshme që ka secili ekip, të aprovuara nga çdo institucion. EILnuk është një ekip që bën ndërhyrje të drejtpërdrejtë për fëmijët viktime të shfrytëzimit për punë, por anëtarët veprojnë si burime në konte.

Përsa i përket mandatit dhe shtrirjes së punës së multi-agjencisë në rajon, kjo ndahet në dy fusha kryesore: organet këshillimore dhe monitoruese, të cilat operojnë shpesh në nivel kombëtar dhe shtetëror/nivel qarku dhe organet që punojnë në nivel lokal për raste specifike.

Organet në nivel lokal kanë tendencën të jenë më të orientuara drejt veprimeve, për shembull, duke marrë pjesë në vendim-marrjeje, planifikim dhe tek zbatimi i masave duke përdorur metodologjinë për menaxhimin e rastit. Në disa raste, këto organe në nivel lokal rregullohen nëpërmjet protokolleve të përbashkëta, udhëzimeve dhe procedurave të cilët mund të jenë të detyrueshme ose jo.

Struktura, përbërja dhe udhëheqja

Krijimi dhe anëtarësimi i qasjeve të multi-agjencisë dhe kush është përgjegjës për të ‘udhëhequr’, është pasqyrim i mandatit dhe shtrirjes së aspirimeve për punën e multi-agjencisë, dhe mënyra sesi është përfshirë (ose jo) tek ligjet dhe politikat kuadër.

Mbase nuk është habi duke pasur parasysh rolin e OJQ-ve në rajon, dhe në shumë raste mbështetja që ofrojnë OJQ-të me shërbime thelbësore, sesi OJQ-të janë thuajse të pandara nga strukturat shtetërore, përsa i përket përbërjes dhe udhëheqjes së mekanizmave të punës së multi-agjencisë.

Për shembull, në **Bosnje – Hercegovinë**, drejtimi i mekanizmave lokal të referimit, të përbërë nga anëtare të institucione të ndryshme, ministrive dhe agjencive jo-qeveritare, dallojnë sipas situatës dhe vendodhjeve. Ndonjëherë OJQ-të drejtojnë referimin dhe ndonjëherë Qendra për Punë Sociale.

Në **Bullgari**, normalisht autoriteti drejtues është organi që punon në këtë fushë. Ka procedura për bashkëpunimin kombëtar me aktorët e ndryshëm publik dhe jo-qeveritar. Këta të fundit, përfaqësohen në këshille dhe komisione për zhvillimin dhe koordinimin e politikave, por në fakt pushteti i tyre real për influence është i kufizuar.

Shembuj nga rajoni

Programi IPA i bashkëpunimit ndër-kufitar Serbi – Mal i Zi, Bashkia Bijelo Polje

Qendra Mbështetëse JU për fëmijët dhe familjet tek bashkia Bijelo Polje, është shërbimi i parë publik në Malin e Zi. Ofron mbrojtje të plotë dhe strehim për fëmijët viktimë të dhunës.

Qendra është shembulli i partneritetit ku bashkëpunimi efektiv dhe qasja multi-disiplinare ka sjellë mbrojtje të shpejtë dhe efektive për fëmijët.

Fëmijët kanë akses për një gamë shërbimesh përfshirë konsultime parandaluese, mbështetjen psikologjike dhe i ndihmojnë për t'u përballur me përvojat traumatike, nga një ekip pedagogësh, punonjësish social, psikologu i shkollës, oficeri i policisë si dhe përfshirja e prindërve.

Në nivel bashkie, Drejtoritë lokale për Asistencë Sociale, Departamenti për Mbrojtjen e Fëmijëve është përgjegjës për krijimin e ekipit multi-disiplinar. Mekanizmi i ndërveprimit është i specifikuar për secilin nga rastet, me pjesëmarrës që variojnë.

Në **Kosovë, Shqipëri, Serbi, Rumani dhe Hungari** funksioni drejtues për punën e multi-agjencive për rastet specifike, është edhe përgjegjësia e shërbimeve shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve (përfshirë Qendrën për Punë Sociale, Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve, etj.). Këto grupe multi-agjencish takohen sipas programit të dakordësuar dhe kanë anëtarësim të ndryshëm sipas natyrës së rastit. Një dallim i rëndësishëm ka ndodhur në Hungari ku puna e multi-agjencive është më e kufizuar dhe varet nga profesionistët për mbrojtjen e fëmijëve të cilët vendosin se kë duhet të përfshijnë.

Shembuj nga rajoni

Një shembull i mirë në Bullgari për promovimin dhe fuqizimin e lidhjeve dhe sinergjive ndër-sektoriale është në fushën e zhvillimit të fëmijërisë së hershme.

Kjo përfshin programe vizitash shëndetësore për prindërit që presin fëmijë dhe fëmijët nën tre vjeç, dhe mbështetet nga UNICEF Bullgari si pjesë e sistemit të kujdesit shëndetësor. Është një ndërhyrje e integruar për të promovuar rritjen, shëndetin, ushqyerjen, zhvillimin socio-emocional dhe konjitiv të fëmijëve.

Një nga objektivat kryesore, krahas fokusit tradicional tek shëndeti dhe ushqyerja, është edhe identifikimi i hershëm i fëmijëve në rrezik abuzimi, neglizhimi dhe braktisjeje si dhe ndërhyrje e hershme në bashkëpunim me sistemet për mbrojtjen e fëmijëve. Familjet që identifikohen në nevojë për asistencë të mëtejshme, i referohen Qendrës për Familjet, e cila ofron mbështetje dhe këshillim social për familjet e pafavorizuara dhe anëtarët e familjes, ndihmë me planifikimin familjar dhe zhvillimin e aftësive prindëror, ofrojnë informacion mbi shëndetin dhe anën ligjore dhe lehtësojnë aksesin për t'i orientuar drejt shërbimeve (p.sh. shërbime strehimi, kujdes shëndetësor, arsim, përfitime sociale dhe punësim).

Tryezat e rrumbullakta për Menaxhimin e rastit (TRM) janë një model që përdoren në Kosovë si mekanizëm koordinues për mbrojtjen e fëmijëve, dhe është një nga modelet më të zakonshme. Në përmjet takimeve mujore, ku marrin pjesë një numër profesionistësh nga institucionë të ndryshme si Njësia, Drejtoria Arsimore, psikologë, oficerë policie, avokatë të viktimës, shërbimi i provës, oficerët e anti-trafikimit, të cilët ndër të tjera menaxhojnë rastet shqetësuese. TRM drejtohet nga punonjësi social që menaxhon rastin në fjalë. Synimi i TRM-së është të mbledhë një ekip multi-disiplinar profesionistësh, të cilët kanë përgjegjësi për të mbrojtur fëmijët dhe nëpërmjet këtij mekanizmi menaxhojnë rastet që janë në rrezik të mesëm ose të lartë neglizhimi, abuzimi, shfrytëzimi, trafikimi dhe krimi. Profesionistët që ftohen në takim variojnë sipas nevojave që ka secili rast dhe nëpërmjet menaxhimit të përbashkët, secili prej profesionistëve merr një përgjegjësi të caktuar për të përmbushur detyrën për menaxhimin e rastit dhe raporton teksa monitorohet rasti.

Si në shumë vende, edhe në Malin e Zi, Qendra për Shërbime Sociale krijon një ekip profesionistësh për të ndihmuar viktimat, por edhe organe të tjera mund të krijojnë ekipe. Ekipet duhet të përbëhen nga përfaqësues të Qendrës për Punë Sociale, autoritetet vendore, policia, organizatat jo-qeveritare, ekspertë të fushës së dhunës në familje. Megjithatë, nuk ekzistojnë shumë të dhëna se kush duhet të drejtojë këtë bashkëpunim, nëse anëtarësimi është i detyrueshëm (ose jo) dhe faktorët të tjerë si afatet kohore për takimin.

Në rajon, struktura dhe përbërja e mekanizmave të ndryshëm të punës së multi-agjencive varion sipas mandatit dhe shtrirjes së mekanizmit si dhe nëse mbështetet në ligj/politika. Shumë nga puna e multi-agjencive që ekziston në rajon lidhet me mbështetjen e rasteve individuale.

Në përgjithësi, aty ku ekziston, puna udhëhiqet kryesisht nga shërbimet sociale/agjencitë për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo është sidomos e vërtetë për rastet individuale të abuzimit të fëmijëve, sidomos kur adoptohet një qasje për menaxhimin e rastit.

Ngritja e kapaciteteve

Është kompleks çështja e ngritjes së kapaciteteve kur flitet për punën e multi-agjencive. Profesionistët, partnerët që marrin pjesë kanë nevojë të paktën për dy llojë kapacitetesh: së pari, për aspektet ‘teknike’ të mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijës, përfshirë të drejtat e fëmijës dhe abuzimin e fëmijës; së dyti për rolin dhe përgjegjësitë e çdo anëtari tek ekipi i multi-agjencive dhe tek procesi i punës bashkë. Kjo përfshin edhe aftësitë thelbësore për drejtuesit si të koordinojnë dhe moderojnë punën e përbashkët dhe idealist duhet të bëhet me grupe multi-agjencish për të mbështetur konceptin e bashkëpunimit nga fillimi.

Veç kësaj, trajnimi dhe udhëzimi është i nevojshëm për të mbështetur zbatimin e qasjeve të multi-agjencive dhe për ta përqafuar në praktikë.

Shembuj nga rajoni

Instituti Jordan për Familjet tek Universiteti i Karolinës së Veriut, Shkolla për Punë Sociale Eörl Vision, dhe USAID zhvilluan kurikula të ndryshme trajnimi për në Rumani.

Kurikula për Menaxhimin e Rastit për Mirëqenien e Fëmijës përbëhet nga tetë module; bazat e menaxhimit të rastit; bashkëpunimi në komunitet dhe zhvillimi i burimeve; vlerësimi i mbështetur tek pikat e forta; vetë-kujdesi për menaxherët e rastit; shërbime dhe mbështetje e vazhdueshem; kompetencat kulturore dhe planifikimi me familjet.

Kurikula Themelore për Supervizorët për Mirëqenien e Fëmijëve përbëhet nga tetë module: panorama e supervizimit të punës sociale; pesë rolet e supervizimit dhe menaxhimi i programit; parimet mësimore për të rriturit dhe stilet e ndryshme individuale mësimore; fazat e zhvillimit në grup dhe krijimi i ekipeve; takimi me grupet; koha, menaxhimi i stresit dhe aftësitë e delegimit; zhvillimi dhe forcimi i misionit të programit tuaj; rekrutimi i punonjësve të rinj.

Kurikula për Supervizorët dhe Menaxherët me Përvojë në Mirëqenien e Fëmijëve ofron një trajnim më të avancuar për supervizimin e mirëqenies së fëmijës. Përbëhet nga gjashtë module; trajnimi dhe motivimi i punonjësve; menaxhimi i punës së punonjësve; aftësitë për menaxhimin e konfliktit; menaxhimi i ndryshimit dhe marrja e vendimeve etike; ndërtimi i komunitetit nëpërmjet dialogut me komunitetin; linçimi i programeve dhe partneriteteve të reja.

Megjithatë, duhet theksuar se ky trajnim është për stafin që kujdeset për mirëqenien e fëmijëve dhe nuk është një trajnim multi-agjencish. Kjo është një qasje e ngjashme me atë në shtete të tjera duke prezantuar trajnime më të formalizuara.

Është e vështirë të imagjinosh sesi mund të kryhet në mënyrë të suksesshme dhe të qëndrueshme ngritja e kapaciteteve pa zhvilluar një plan gjithëpërfshirës.

Si një shembull që ka bërë një studim vlerësues është **Shqipëria** (ËVA, 2013), që theksoi përpjekjet për të rritur kapacitetet e punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve nga **INGOs**, OJQ-të, dhe agjencia shtetërore për fëmijët, UNICEF-i dhe Ministria për Mirëqenien Sociale dhe Rininë. Megjithatë, studimi arrin në përfundimin se trajnimi (ndonjëherë edhe këshillimi për rastet) është i copëzuar dhe mbështetet kryesisht tek aktivitetet e partnerëve të interesuar, përfshirë edhe nivelin e angazhimit të Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve, që ka nevojë për lejen e supervizorit dhe/ose kryetarit të komunës / bashkisë për të marrë pjesë.

Si në vende të tjera në rajon, Bosnja dhe Mali i Zi kanë zbatuar shumë trajnime për tema të ndryshme si trafikimi, dhuna në familje, si dhe trajnime për zbatimin e ligjit të ri për drejtësinë për të mitur, që mbledh të gjithë profesionistët në gjykata dhe jashtë saj.

Për trajnimin specifik të punës së multi-agjencive ka prova se është kryer. Për shembull, si në Moldavi dhe në Kosovë ka burime kastile për këtë aktivitet. Qeveria, në partneritet me OJQ-të kryejnë aktivitete trajnimi për punonjësit e ekipit multi-disiplinar mbi bashkëpunimin e inter-agjencive. Trajnimet bëhen nga OJQ-të dhe në përgjithësi kanë nivel pjesëmarrjeje dhe janë të vazhdueshme, ku theksi vendoset tek qasjet inter-aktive, bëhen diskutime për raste konkrete nga praktika e pjesëmarrësve. Veç kësaj, në Moldavi, Departamenti për Familjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nëpër qarqe në vend, ka plane vjetore trajnimi që përfshijnë edhe punën e multi-agjencive, megjithëse shpesh këto trajnime janë më shumë informuese sesa formuese/aktive.

Fatkeqësisht, në disa vende nuk ka shumë mundësi për ngritje kapacitetesh si informale apo formale. Për shembull, në Hungari edhe pse profesionistët për mbrojtjen e fëmijëve marrin trajnim, shumë pak ose nuk ju ofrohet aspak trajnim të tjerëve që janë përfshirë në punën e multi-agjencisë. Në Bullgari trajnimi ofrohet më gjerësisht, por bëhet në mënyrë lokale dhe zakonisht prej OJQ-ve në projekte, dhe si rezultat nuk është i qëndrueshëm për të ardhmen. Deri në një farë mase kjo ilustron

boshllëkun midis synimeve të shteteve për të zhvilluar qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë punën e multi-agjencive, dhe disponueshmërisë së burimeve dhe përpjekjeve të nevojshme për zbatimin.

Serbia është një shembull tjetër, ku Plani Kombëtar i Masave thekson nevojën për më shumë trajnim për profesionistët nga institucionet e ndryshme që do të ndihmonin për të punuar në mënyrë me efikënte bashkë, por ka pak të dhëna nëse janë ofruar trajnime, kush i organizon për kë dhe cilat janë rezultatet.

Në **Rumani** trainimet janë të disponueshme për anëtarët e EIL, dhe më e rëndësishme është se secili prej anëtarëve kanë planin e vetë të zhvillimit profesional, të përgatitur nga institucionet e tyre. Megjithatë, shumica e trajnimeve ofrohet nga OJQ-të dhe donatorët sesa nga institucionet. Trajnime janë kryer edhe në Maqedoni me mbështetjen e UNICEF-it dhe as këtu nuk është adoptuar ende nga Inspektoriat dhe Departamenti i Trajnimit i Ministrisë së Shërbimeve Sociale. Për ironi të fatit, kriza e fundit migratore / refugjatëve vuri në lëvizje Grupin e Punës për Mbrojtjen e Fëmijëve në Maqedoni, për të përgatitur plane zhvillimi më gjithëpërfshirës për ngritjen e kapaciteteve. Kjo përqafon edhe sistemin më të gjerë të mbrojtjes së fëmijëve dhe shqetësimet për fëmijët në vend. E njëjta gjë është planifikuar për Serbinë.

Megjithëse shumica e trajnimeve dhe aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve mbeten informale, ka përpjekje për të ngritur sistem më të formalizuar trajnimesh. UNICEF-i, Ministria e Punës dhe Shërbimeve Sociale si dhe OJQ-të e ndryshme, të koordinuara nga Terre des hommes në **Shqipëri** ka zhvilluar një program trajnimi në detyrë që e zbaton Universiteti i Tiranës, i cili është në proces akreditimi. **Rumania** ka zhvilluar një program standard trajnimi. Save the Children planifikon të zhvillojë një kurs të ngjashëm në **Bosnje Hercegovinë**.

Zhvillimi i një programi gjithëpërfshirës dhe akreditimi, që përfshin edhe punën e multi-agjencive, është një hap i rëndësishëm për të krijuar një platformë të qëndrueshme për ngritjen e kapaciteteve. Kjo përmirësohet më shumë kur kontetë përfshijnë kërkesa specifike për trajnim. Për shembull, në Bosnje Hercegovinë, Ministria e Drejtësisë kërkoi zhvillimin e programeve zyrtare të trajnimit dhe ju vendosi si detyrim të gjithë profesionistëve që punojnë me të miturit në kontakt me ligjin të marrin pjesë tek këto kurse dhe të marrin certifikata zyrtare.

Në shumë raste, forca kryesore e drejtimit dhe ofruesit e shërbimeve të ngritjes së kapaciteteve janë OJQ-të dhe UNICEF, pasi agjencitë qeveritare nuk kanë burime. Kjo përfshin si trajnimin fillestar dhe në disa raste këshillim / supervizim të vazhdueshëm për menaxhimin e rastit (por që nuk funksionojnë si ekipe multi-agjencish). Duke qenë se ky trajnim lidhet shpesh me interesat e agjencive pjesëmarrëse, nuk është domosdoshmërisht gjithëpërfshirës dhe as i qëndrueshëm për një periudhë afatgjatë duke pasur parasysh që nuk është i institucionalizuar.

Faktorët kufizues për maksimizimin e efektivitetit të ngritjes së kapaciteteve është ndryshimi i shpeshtë i stafit dhe mungesa e burimeve.

Monitorimi

Pavarësisht theksit që vendoset tek puna e multi-agjencisë për mbrojtjen e fëmijëve dhe burimeve të konsiderueshme që janë vendosur në rajon për krijimin e punës së multi-agjencive, monitorimi është shumë pak sistematik (ose është sporadik). Pjesërisht, kjo pasqyron një mungesë të përgjithshme standardesh gjithëpërfshirëse dhe kuadër monitorimesh. Për shembull, në Moldavi mungon sistemi i monitorimit, ndërsa standardet dhe sistemi i monitorimit është në zhvillim e sipër në **Rumani** dhe në **Shqipëri**.

Sigurisht, shumë shtete kanë bërë programe vlerësimi për fushën e mbrojtjes së fëmijëve (si në Kosovë dhe në Shqipëri) dhe në varësi të mënyrës sesi është kryer vlerësimi, mund të konsiderohet si element i saj është puna e multi-agjencisë. Megjithatë, këto vlerësime shpesh marrin më shumë në konsideratë situatat kritike të fëmijëve sesa procesin dhe efektivitetin e punës së multi-agjencive.

Krahas kësaj, siç edhe përmendet më sipër, shumë shtete kanë në teori një strukturë që ka edhe një pjesë përgjegjësie për monitorimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve. Këto mund të jenë agjenci shtetërore ose organe të pavarura si Avokati i Popullit, si në rastin e **Malit të Zi**.

Në Kroaci u bë një përpjekje për të rishikuar procesin e punës së multi-agjencisë. OJQ-ja Step by Step bëri një studim gjithëpërfshirës mbi perceptimin e bashkëpunimit midis institucioneve që janë të përfshirë tek mbrojtja e fëmijëve. Pjesëmarrësit përfshinin prindërit, mësuesit dhe profesionistë të tjerë. Kur vlerësohet pajtueshmëria e institucionit me politikën, shpejtësia e reagimit dhe bashkëpunimi dhe ndarja midis institucioneve, pikët mesatare ishin 3 nga 5, ku bashkëpunimi dhe ndarja kishin edhe pikët më ultra.

40% e të intervistuarave e konsideronin thuajse non-ekzistent midis institucioneve të ndryshme. Mungesa e koordinimit dhe strategjive të përbashkëta u identifikuan si arsyeja kryesore që sillte probleme në bashkëpunim. U identifikua edhe mungesa e financave, si dhe mungesa e motivimit personal dhe marrëdhënies midis profesionistëve si arsye për bashkëpunimin e dobët.

Janë bërë vlerësime të ndryshme në rajon për mbrojtjen e fëmijëve, megjithatë pak studime kanë marrë në konsideratë punën e multi-agjencive dhe efektshmërinë e tyre. Atje ku është bërë një studim, ka marrë në konsideratë shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve në tërësi, dhe në veçanti zbatimin e qasjes së menaxhimit të rastit.

Mungesa e standardeve dhe bazave për praktikën, e pengon edhe më shumë punën e multi-agjencisë. Edhe aty ku ekzistojnë protokolle pa standarde dhe pa baza inspektimi, ka gjasa të ketë mungesë konsistence për shkak se interpretimi i protokollit dhe zbatimit të tij, i lihet individëve. Kjo kufizon edhe mënyrën sesi ato që mësohen në praktikë të mund të përkthehen tek zhvillimet e ardhshme.

Perceptimi i efektivitetit

Krahas mungesës së strukturave të forta për të monitoruar funksionimin e punës së multi-agjencive, është e mundur që të bëhet një vlerësim nëpërmjet perceptimit të atyre që janë në kontakt dhe përfshihen me punën e multi-agjencive.

Në shumë vende, puna e multi-agjencive shihet të paktën si pjesërisht efektive, si në Moldavi, Kosovë dhe Bosnje Hercegovinë, sigurisht më vështirësitë e saj, ndërsa në Hungari dhe në Bullgari janë identifikuar probleme të rëndësishme për të bërë realitet punën e multi-agjencisë.

Shembuj nga rajoni

Në Hungari, Shoqata Anthropolis, në bashkëpunim me OJQ të tjera si Kryqi i Kuq, NaNe, linja telefonike për fëmijët Blue Line, kanë organizuar një seri tryezash të rrumbullakta multi-disiplinari mbi skllavërinë e ditëve moderne.

Komentet nga profesionistët në Miskolc, Nyiregyháza dhe Kecskemét, vinin në pah disa nga vështirësitë e punës së multi-agjencive. Kjo përfshinte edhe diskutimin e rastit që nuk organizohej sistematikisht dhe se trajnimet që bëheshin ishin më shumë në formën e konferencave me prezantime formale, në vend të diskutimeve praktike, aktuale të rastit dhe ndarjes së eksperiencave.

Profesionistët vunë në dukje se bashkëpunimi varej nga marrëdhëniet personale, por në mungesë të mundësive për takime të përbashkëta, kjo nuk është e mundur. Profesionistët e kujdesit shëndetësor, mësuesit, gjykatësit dhe prokurorët shpesh nuk marrin pjesë në takime dhe refuzojnë bashkëpunimin pa asnjë justifikim. Profesionistët e shëndetit mendor dhe të kujdesit shëndetësor shpesh citojnë udhëzimet e tyre etike mbi privatësinë për të mos ndarë informacionin.

Megjithëse të gjitha këto probleme janë adresuar tek Manuali Metodologjik që ka nxjerrë Ministria e Burimeve Njerëzore (2014), shumë profesionistë nuk kanë dijeni për ekzistencën e këtij dokumenti udhëzues dhe prandaj ka pasur pak impakt.

Një numër problemesh të përbashkëta nga këto shtete përfshijnë:

- **Koha** është e nevojshme për të përcaktuar dhe për të zhvilluar punën e multi-agjencive. Si u vu re në Malin e Zi, kur u prezantua puna e multi-agjencive, duhet kohë dhe përpjekje për të mësuar bashkë në mënyrë efektive.

- **Koordinimi dhe bashkëpunimi** vështirësohen prej një sërë aspektesh të sjelljes, teknike dhe strukturore të ndërveprimit reciprok. Kjo lidhet si me mënyrën sesi janë organizuar strukturat dhe sesi ofrohen shërbimit në realitet dhe deri në ç'masë është përfshirë në ligj / politikë. Për shembull, në Shqipëri pavarësisht protokollit të vjetër që parashikon punën e multi-agjencive në rastet e mbrojtjes së fëmijëve, duke qenë se nuk kishte detyrim formal për agjencitë e tjera të respektonin protokollin, pjesëmarrja e aktorëve të tjerë ishte e kufizuar. Ndërsa sipas një analize që bëri Avokati i Popullit, stafi juridik në Malin e Zi mendonte se puna e tyre me punonjësit social ishte përmirësuar sidomos për trajtimin e rasteve të shfrytëzimit seksual të fëmijëve.
- **Sistemet tepër të komplikuar dhe paralele** që janë ndërtuar mbi ndërhyrjet multi-disiplinare që përfshijnë kategori të ndryshme përfituesish si fëmijët në nevojë për mbrojtje, viktime të trafikimit, fëmijët në situatë rruge, etj, të cilët mund të ekzistojnë në nivele të ndryshme të administratës mund të krijojnë dublikim dhe konfuzion. Për shembull, të njëjtët persona janë anëtarë të grupeve të ndryshme. Krahas kësaj, shumë struktura nuk krijohen si reagim për problemet e komunitetit apo për të lehtësuar vendim-marrjen në nivel komuniteti, por sepse janë disa akte normative që kërkojnë krijimin e tyre, pa asnjë studim fizibiliteti mbi përshtatshmërinë dhe nevojën për to.
- **Marrëdhëniet personale** konsiderohen të rëndësishme për punën efektive të multi-agjencisë. Sidomos në **Bosnje-Hercegovinë** u vu re se kur profesionistët e njohin njëri tjetrin, bashkëpunimi është më i madh dhe prandaj ekipi konsiderohet dhe më efektiv krahasuar me fusha të tjera kur profesionistët nuk njihen me njëri tjetrin. Puna së bashku nuk ndodh gjithmonë si rezultat i qasjes menaxheriale, por edhe nga iniciative personale e aktorëve të përfshirë për çështje të izoluara, situata dhe raste.
- **Kultura dhe mendësia** duhet të përshtaten. Puna e multi-agjencisë është një bashkëpunim horizontal dhe si e tillë sfidon strukturat hierarkike tradicionale dhe statusin profesional. Puna rajonale regjionale është një koncept relativisht i ri dhe nuk është shumë pjesë e kulturës, prandaj edhe krijon vështirësi për mentalitetin e profesionistëve që të punojnë bashkë dhe të ndajnë kompetencat.

- **Sinergjitë dhe lidhjet midis aktorëve** ose forcojnë ose dobësojnë punën e multi-agjencive. Ndonjëherë lidhet me ligjin dhe herë të tjera me qëndrimin e stafit. Për shembull, raportohet një tendencë midis punonjësve social të konsiderojnë veten si nëpunësit e vetëm zyrtarë kompetent dhe përgjegjës për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve. Në të njëjtën kohë ka një mendësi midis profesionistëve të punës sociale tek OJQ-të se institucionet publike janë inkompetente, njohuritë janë të vjetra ose kanë mungesë njohurie dhe aftësish.
